

VENDIM
Nr. 74, datë 28.1.2015

**PËR NDRYSHIMIN, NGA TOKË BUJQËSORE “ARË” NË TOKË URBANE,
“TRUALL”, TË SIPËRFAQES PREJ 15 000 m², NË ZONAT KADASTRALE NR. 2119
DHE NR. 2105, KASHAR, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin, nga tokë bujqësore “arë” në tokë urbane, “truall”, të sipërfaqes prej 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) m², në zonat kadastrale nr. 2119 dhe nr. 2105, Kashar, Tiranë, sipas të dhënave në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, të qarkut Tiranë, të pasqyrojë, në dokumentacionin kadastral përkatës, ndryshimin e kategorisë së resursit, nga tokë bujqësore “arë” në tokë urbane, “truall”, për sipërfaqen prej 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) m², në zonat kadastrale nr. 2119 dhe nr. 2105, Kashar, Tiranë.

3. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të bëjë ndryshimin e llojit të pasurive, në certifikatat e pasurive, sipas të dhënave për pasurinë e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Sipërfaqja e pasurive arë është	15,000 m²
--	-----------------------------

Pasuritë i përket zonës kadastrale nr. 2105 dhe 2119 Tiranë

Nr.	Nr. pasurisë	Sipërfaqja (m2)	Vol.	Faqe	Emër Mbiemër	Zëri kadastral
	Komuna Kashar, Tiranë					
1	95/19	2,462	21	235	Amadeus Palace	arë
2	95/20	2,538	21	236	Besim Elshan	arë
3	95/21	1,971	21	237	Amadeus Palace	arë
4	95/22	3,029	21	234	Hysni Vasili	arë
5	95/23	5,000	11	189	Amadeus Palace	arë
6						
	TOTALI TOKË ARË	15,000	m ²	Tokë arë për t'u konvertuar në tokë urbane		